



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:148304
Datë: 27.02.2025
Numri i dokumentit: 06915830

CN. nr. 378/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me zyrtaren Ligjore Drita Çollaku në çështjen jo kontestimore sipas propozimit të propozuesit, R.M. nga Rahoveci kundër kundër-propozuesve: Xh.D., P.R., S.R., A.R., Sh.R., H.R., M.N. dhe K.D. të gjithë nga Komuna e Rahovecit për rregullimin e megjëve, në seancë, me datë 27 Shkurt 2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet i tërhequr propozimi në këtë çështje jo kontestimore.

A r s y e t i m

Propozuesi R.M. nga Rahoveci me datë 09.07.2019 ka paraqitur propozim në këtë gjykatë kundër kundërpropozuesve Xh.D., P.R., S.R., A.R., Sh.R., H.R., M.N. dhe K.D. të gjithë nga Komuna e Rahovecit për rregullimin e megjëve, me propozimin e paraqitur ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadisë.

Në seancën e datës 27.02.2025 propozuesi R.M. e ka njoftuar gjykatën se e tërheq propozimin në këtë çështje pasi që me palët kundër propozuese kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Pasi që pala propozuese deklarohet se e tërheq propozimin në këtë çështje, gjykata përshtatshmërisht zbaton nenin 261 të LPK-së, ashtu që vendosi që të konstatohet se propozimi është tërhequr.

Nga arsyet e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
CN. nr. 378/2017 datë 27 Shkurt 2025

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.